



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI"

RAPORT I MONITORIMIT

10.05.2023, Mitrovicë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

1. HYRJE

Zyrtarët përgjegjës të AKA-së për procedurën e monitorimit:

- *Naim Gashi, Drejtor i AKA;*
- *Arianit Krasniqi, Zyrtar i Lartë për Vlerësim dhe Akreditim;*
- *Leona Kovaci, Zyrtare e Lartë për Monitorim dhe Vlerësim.*

Data e fillimit të procedurës së monitorimit: 10.05.2023

Monitorimi është realizuar: a) në distancë
b) me vizitë në terren me paralajmërim
c) me vizitë në terren pa paralajmërim

Data e vizitës monitoruese (nëse aplikohet): 10.05.2023

Personat me të cilët zyrtarët e AKA-së janë takuar në vizitën në terren (nëse aplikohet):

- Gentiana Imeri - Shefe e programeve
- Arbesa Uka – Asistente
- Tringa Didi – Profesoreshë
- Blerta gashi – Administrate
- Shkumbin Vidishiçi - Bibliotekist

Burimet e informimit për raportin e monitorimit:

- *Orari i ligjëratave i publikuar në uebfaqe të fakultetit;*
- *Orari i ligjëratave i vendosur në pano në hapsirat e fakultetit;*
- *Intervista me profesorë/asistentë/zyrtarë të administratës.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

2. Përshkrim i shkurtër i zhvillimit të procedurës së monitorimit për verifikimin e orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve, përfshirë të dhënat në rend kronologjik (nëse aplikohen):

Vizita monitoruese filloi në orën 13:00.

Gjate vizitës, ekipi monitorues u fokusua në fakultetin e Gjeoshkencave, Fakultetin Juridik dhe Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës. Gjatë tërë vizitës ekipi monitorues u shoqërua nga përfaqësues të fakulteteve përkatëse të cilët ishin në dispozicion për të ofruar informatat e kërkuara.

Fillimisht u vërejt se në korridoret e institucionit ende figuronte orari i semestrit dimëror, dhe kjo gjë shkaktonte konfuzitet sepse në asnjë rast nuk përkonte orari, lënda dhe emri i profesorëve i paraqitur në tabelë me orarin, lëndën dhe profesorin që gjindej në sallë.

Ekipi monitorues vizitoi edhe bibliotekën e UMIB-it ku zyrtari përgjegjës shpjegoi mundësitë e qasjes në databazat e EBSKO-s, megjithëse u vërejt se institucioni nuk mbledh të dhëna lidhur me përdoruesit dhe administrimin e kësaj platforme.

Në Fakultetin Juridik, ekipi monitorues ka vërtetuar se një ditë më parë nga shtatë ligjëratat e parapara, janë mbajtur vetëm dy. Arsyeimi i dekanit se kanë qenë të angazhuar me kthimin e përgjigjeve për një proces të akreditimit. Kjo për AKA ka qenë e paqëndrueshme, pasi që kërkesat e AKA-së kanë qenë të drejtuara për stafin menaxhues dhe administratën dhe jo për stafin akademik.

Gjatë vizitës në Fakultetin e Edukimit, u gjet se nga pesë ligjerata të planifikuara, ishin duke u zhvilluar vetëm tri. Megjithatë, ekipi monitorues u njoftua se profesorët kishin njoftuar paraprakisht për mungesën dhe zëvendësimin e orëve të humbura.

Ekipi monitorues u njoftua se lënda Bazat e Arsimit Muzikor është zhvendosur për vitin tjetër. AKA kërkon të pajiset me të gjithë dokumentacionin lidhur me zhvendosjen e kësaj lënde për të siguruar se është marrë parasysh ngarkesa e punës së studentëve dhe shpërndarja e kredive ECTS.

Siç ishte e njoftuar edhe më parë, gjatë monitorimit AKA konfirmoi se Fakulteti i Edukimit nuk ka një profesor të rregullt për lëndën e matematikës dhe për këtë lëndë institucioni ka angazhuar prof. Xhevdet Thaçin i cili është i rregullt në Universitetin e Gjilanit. Ekipi monitorues u njoftua se profesori Thaçi ka kërkuar që ligjëratat e lëndës së Matematikës të mbahen të shtunave, dhe si rezultat i mosdakordimit me studentë kjo lëndë nuk është mbajtur pothuajse asnjëherë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

AKA kërkoi listat e vijueshmërisë së lëndës së matematikës për vitet akademike 2021-22 dhe 2022-23 si dhe listen e pjesëmarrjes së studentëve në provime.

3. VLERËSIMI PËRFUNDIMTARË

1. Orari i ligjeratave i paraqitur në korridoret e fakulteteve të vizituara është ende i semestrit dimëror dhe kjo gjë shkakton konfuzitet.
2. Lënda Bazat e Arsimit Muzikor është zhvendosur nga njëri vit në tjetrin dhe nuk është i qartë procesi i zhvendosjes.
3. Lënda e matematikës në Fakultetin e Edukimit nuk është mbajtur rregullisht për arsye të mungesës së profesorit të rregullt për këtë lëndë.

4. Rekomandim

1. Meqenëse në Fakultetin e Edukimit nuk është mbajtur lënda e matematikës dhe dëshmitë e kërkuara nuk i janë ofruar AKA, i rekomandojmë AKA që të kërkoj një raport me shkrim për mbarëvajtjen e kësaj lënde mësimore dhe të ofrohen garanci se studentët kanë mbajtur ligjëratat e përcaktuara në program. Meqenëse programi parashihet t'i nënshtrohet procesit të riakreditimit, nuk preferohet procedura follow up, por raporti me të gjetura t'i dorëzohet ekipit vlerësues.

2. Për shkak të parregullsive të evidentuara në mbarëvajtjen e mësimit në Fakultetin Juridik, nuk rekomandohet procedura follow up, pasi që programi sivjet i nënshtrohet procesit të riakreditimit, por rekomandohet që raporti i monitorimit t'i dërgohet ekipit vlerësues.

4. SHTOJCAT (nëse aplikohet)

1. A
2. B
3. C



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Zyrtarët për Vlerësim dhe Monitorim të AKA-së

Kryesues

NAIM GASHI

(Emri dhe Mbiemri)

[Signature]

(Nënshkrimi)

20.10.2023

(Data)

Anëtar

Armenit Kasimaj

(Emri dhe Mbiemri)

[Signature]

(Nënshkrimi)

20.10.2023

(Data)

Anëtar

Leona Korsi

((Emri dhe Mbiemri)

[Signature]

(Nënshkrimi)

20.10.2023

(Data)